

LIGJ
Nr. 25/2022

PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-eve
(ndryshuar me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

Qëllimi i këtij ligji është hartimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm, për:

1. krijimin e zhvillimin e *startup*-eve dhe të veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. mbështetjen e ekosistemit vendas të *startup*-eve dhe integritimit me ekosistemin ndërkombëtar për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve e proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.

Neni 2

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat dhe organet shtetërore, që rregullojnë, mbështesin, zhvillojnë dhe integrojnë ekosistemin e *startup*-eve të Republikës së Shqipërisë, si dhe format e mbështetjes së punonjësve lëvizës digjitalë.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar shkronja “ç” me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Ekosistem mbështetës për *startup*-et” nënkupton bashkëveprimin e individëve, *startup*-eve, si dhe organizatave të tjera që veprojnë si lehtësues, të cilët bashkërisht veprojnë si inkubator për krijimin e rritjen e *startup*-eve;
- b) “Inkubim” është procesi i mbështetjes, përgatitjes, transformimit të idesë në model biznesi dhe i zhvillimit të një *startup*-i në fazën fillestare të tij;
- c) “Lehtësues të *startup*-eve” janë aktorët e ndryshëm të ekosistemit që ofrojnë programe dhe shërbime mbështetëse për *startup*-et, përfshirë por pa u kufizuar në: inkubatorë, përsheptues, ofrues ambientesh dhe pajisjesh pune, mentorues, këshillues, trajnues, ofrues asistence përgjatë zhvillimit të biznesit, qendra teknologjike dhe inovacioni, organizatorë eventesh, institucione të

arsimit parauniversitar, shkollat e arsimit profesional, institucione të arsimit të lartë, organizata kërkimore, ofrues të shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare apo të biznesit, si dhe subjekte që u ofrojnë *startup*-eve financime alternative si investim kapitali, investim kapital risku (*venture capital*), skema *voucher* për inovacionin (*innovation vouchers*), engjëj biznesi (*business angels*).

c) “punonjësit lëvizës digjitalë” janë shtetasit e huaj, që përdorin teknologjinë e komunikimit për të ofruar shërbimet e tyre profesionale dhe/ose kryejnë këto shërbime për llogari të entiteteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa pasur një zyrë apo seli të regjistruar, të cilët marrin statusin dhe përfitimet e “punonjësit lëvizës digjital” në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;

d) “Startup” janë individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.

Neni 4

Objektivat e mbështetjes së *startup*-eve

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve ka për synim:

- a) lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së *startup*-eve;
- b) krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore;
- c) lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare;
- ç) përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike.

Neni 5

Format e mbështetjes së *startup*-eve

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimit “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e *startup*-eve;
- b) zhvillimit të ekosistemit mbështetës për *startup*-et;
- c) dhënies së granteve financiare ose masave mbështetëse për zhvillimin e *startup*-eve;
- ç) formave të tjera mbështetëse e lehtësuese të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5/1

Format e mbështetjes së punonjësve lëvizës digjitalë

(shtuar me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Përfshirja nga përkufizimi i rezidencës tatimore, siç përcaktohet në legjislacionin tatimor, punonjësit lëvizës digjitalë nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 12 muajsh.

2. Pavarësisht ndonjë dispozite të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, një entitet jorezident nuk do të konsiderohet që krijon seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë vetëm se merr shërbime nga një punonjës lëvizës digjital ose vetëm sepse ka punësuar një punonjës lëvizës digjital.

3. Veprimtaria e punonjësit lëvizës digjital nuk konsiderohet se krijon një vend fiks biznesi dhe nuk konsiderohet se vepron si një agjent i pavarur i një entiteti jorezident në Republikën e Shqipërisë për sa kohë punonjësi lëvizës digjital nuk ka autoritetin të përfundojë kontrata në

emër të entitetit jorezident apo nuk angazhohet në ndonjë veprimtari që nuk është e lidhur me rolin e tij si punonjës lëvizës digjital.

4. Punonjësit lëvizës digjitalë pajisen me leje unike bazuar në ligjin “Për të huajt” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6

Organet përgjegjëse

(shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

Organet përgjegjëse në fushën e nxitjes, ndihmës dhe zhvillimit të *startup*-eve, sipas këtij ligji, janë:

- a) ministri përgjegjës për sipërmarrjen;
- b) Këshilli i *startup*-eve;
- c) ministritë ose institucionet e tjera publike;
- ç) agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve.

Neni 7

Detyrat e ministrit përgjegjës për sipërmarrjen

(ndryshuar shkronjat “d”, “e” dhe “f”, shfuqizuar shkronjat “g” dhe “h” me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:
 - a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e mbështetjes së *startup*-eve;
 - b) koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të *startup*-eve në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të sipërmarrjes në vend;
 - c) koordinon me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;
 - ç) i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
 - d) miraton modelet tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që nënshkruhen ndërmjet agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;
 - dh) miraton dhe publikon thirrjet për grante financiare ose masa mbështetëse, ku evidentohet forma dhe sasia e granteve financiare ose forma e masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;
 - e) miraton rregullat e procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të *startup*-eve;
 - ë) mbikëqyr administrimin e regjistrit të *startup*-eve dhe të lehtësuesve në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
 - f) administron faqen zyrtare në internet të institucionit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, si edhe publikon thirrjet për grante;
 - g) asiston zhvillimin e ekosistemit mbështetës për *startup*-et;
 - gj) shfuqizuar;
 - h) shfuqizuar;
 - i) vepron si organ mbështetës për *startup*-et, lehtësuesit dhe palët e treta duke bërë të mundur tërheqjen dhe duke mbështetur alokimin e fondeve ose të granteve të donatorëve të huaj për *ekosistemin* në Shqipëri;
 - j) bashkëpunon me institucionet vendase, organizatat ndërkombëtare dhe me organizatat jofitimprurëse vendase e të huaja për rritjen e ndërgjegjësimit publik në fushën dhe veprimtarinë e *startup*-eve, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ky ligj;

k) të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

2. Në ushtrimin e detyrave të tij sipas përcaktimeve të këtij ligji, ministri përgjegjës për sipërmarrjen ndihmohet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, i cili e ushtron veprimtarinë bazuar në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar.

Neni 8

Këshilli i *startup*-eve

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Këshilli i *startup*-eve (në vijim “Këshilli”) ngrihet pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe jep kontribut në nxitjen e zhvillimit të *startup*-eve si organ kolegjal, që vepron në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike.

2. Kryetar i Këshillit është ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

3. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve vepron si sekretariat teknik i Këshillit dhe e mbështet atë për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky ligj.

4. Rregullat e hollësishme për përbërjen e Këshillit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit, kompetencat, organizimin e funksionimin e Këshillit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Detyrat e ministrive ose të institucioneve të tjera publike

Ministritë ose institucionet e tjera publike, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të tyre, kryejnë detyrat e mëposhtme:

a) asistojnë procesin e mbështetjes dhe të zhvillimit të *startup*-eve në përputhje me parimin pa letër dhe tarifa zero në ofrimin e shërbimeve. Shërbimet për të cilat, në kuadër të këtij ligji, aplikohet tarifa zero përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) japin mendim të arsyetuar për përputhjen ligjore midis aplikimit të *startup*-it, lehtësuesit ose palëve të treta, kërkues për grante ose masa mbështetëse dhe fushën e tyre të aktivitetit;

c) kryejnë të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 9/1

Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve

(shtuar me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve është njësi menaxhuese dhe monitoruese e realizimit të masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose me të tretë për nismat në ekosistemin e *startup*-eve.

2. Rregullat për funksionimin dhe organizimin e agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

MBËSHTETJA E *STARTUP*-EVE

Neni 10

***Startup*-et**

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Individi, personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital, merr statusin si *startup* në momentin e plotësimit të një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe lehtësuesve.

2. Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit dhe e statusit si *startup* është 24 (njëzet e katër) muaj nga momenti i vetëdeklarimit në regjistrin e *startup*-eve, me të drejtë rinovimi.

3. Vetëdeklarimi dhe marrëdhënia e *startup*-eve dhe lehtësuesve me ekosistemin mbështetës të tyre dhe skemën e mbështetjes së *startup*-eve dhe lehtësuesve kryhet duke u bazuar në parimet pa letër dhe tarifa zero në marrjen e shërbimeve.

Neni 11

Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve (në vijim “Regjistri”) administrohet nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve, si bazë shtetërore të dhënash, në funksion të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

2. Regjistri shërben për vetëdeklarimin e *startup*-eve dhe lehtësuesve, për mbajtjen e të dhënave të *startup*-eve dhe të lehtësuesve të vetëdeklaruar, për kërkuesit dhe përfituesit e granteve dhe të masave të tjera mbështetëse.

3. Në momentin e vetëdeklarimit të *startup*-it nga individi, personi fizik ose juridik, në regjistrin e *startup*-eve automatikisht gjenerohet numri personal dhe dokumenti elektronik, pasaporta e *startup*-eve.

4. Lehtësuesit të *startup*-eve, në momentin e regjistrimit në regjister sipas këtij ligji, i gjenerohet automatikisht numri personal dhe dokumenti elektronik, pasaporta e lehtësuesve.

5. Rregullat e hollësishme për përmbajtjen e regjistrit, mënyrën e funksionimit të regjistrit dhe ndërlidhjen e tij me portalin *e-Albania*, si dhe për dokumentet elektronike, pasaporta e *startup*-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Mbështetja e *startup*-eve nëpërmjet shërbimit *startup one-stop-shop*

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe rritjes së *startup*-eve, ofrohet shërbimi *startup one-stop-shop* pranë agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve.

2. Shërbimi *startup one-stop-shop* mund të ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe në të përfshihen:

a) dhënia e informacionit mbi kuadrin ligjor rregullator në fuqi, përfshirë por pa u kufizuar në informacionin mbi detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë, si dhe mbi detyrimin për regjistrim në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe mbi detyrimet fiskale dhe/ose detyrime të tjera që do t’u nënshtrohen individët e vetëdeklaruar si *startup* pas periudhës së inkubimit;

b) dhënia e këshillimit lidhur me regjistrimin në regjistrin tregtar dhe mbrojtjen e të drejtave civile dhe tregtare, si dhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale pas periudhës së inkubimit;

c) organizimi i aktiviteteve informuese dhe njohëse ndërmjet *startup*-eve të interesuara;

ç) dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të *startup*-eve, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Rregullat e hollësishme për veprimtarinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit *startup one-stop-shop* përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Mbështetja e *startup*-eve nëpërmjet ekosistemit

1. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen merr masa dhe angazhohet për të asistuar e bashkërenduar veprimtarinë e ekosistemit mbështetës për *startup*-et dhe asiston *startup*-et dhe lehtësuesit e përfshirë në ekosistem në bashkëpunim me Këshillin. Mënyra e bashkërendimit dhe e asistimit në veprimtarinë e ekosistemit, parashikuar në këtë pikë, do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Individit, personi fizik ose juridik, që ka fushë kryesore të veprimtarisë trajnimin ose dhënien e mbështetjes nëpërmjet formave të ndryshme në fushën e inovacionit dhe/ose teknologjisë ose në fusha të ngjashme me to, merr statusin e lehtësuesit të *startup*-eve, duke u vetëdeklaruar në regjistrin e *startup*-eve.

3. Kriteret e hollësishme për kapacitetet njerëzore, administrative dhe infrastrukturore të lehtësuesve të *startup*-eve, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Mbështetja e *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse

(ndryshuar pikat 2, 4, 6 dhe 7 me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. *Startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve të vetëdeklaruar në regjistër mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë, por pa u kufizuar në donacionet e huaja dhe/ose nga investimet e lehtësuesve, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.

2. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve i propozon ministrit përgjegjës për sipërmarrjen shpalljen e thirrjes për aplikime nga ana e *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve dhe kryen publikimin në shërbimin *startup* one-stop-shop në faqen zyrtare.

3. Thirrja për aplikime për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, procedurat dhe afatet respektive, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh prioritetet e përgjithshme si më poshtë:

- a) mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
- b) mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
- c) fuqizimi i të rinjve;
- ç) fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse;
- d) fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
- dh) prioritetet e tjera, sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

4. Me qëllim vlerësimin e kërkesave nga *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve ngrihet komisioni i vlerësimit dhe komisioni i ankimit. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen cakton kryetarët e këtyre komisioneve. Rregullat e hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. *Startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve aplikues shpallen fitues me vendim të komisionit të vlerësimit vetëm nëse plotësojnë kriteret dhe përcaktimet e pikës 3 të këtij neni.

6. Vendimi i komisionit të vlerësimit për përfituesit e granteve financiare për mbështetjen e *startup*-eve, sipas thirrjes dhe në përfundim të procesit të ankimit, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen. Urdhri botohet në faqen zyrtare të agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

7. Urdhri i ministrit përgjegjës për sipërmarrjen zbatohet nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e startup-eve.

Neni 15

Monitorimi i masave mbështetëse

(ndryshuar pika 1, shfuqizuar pika 4, me ligjin nr. 36/2023, datë 25.5.2023)

1. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e startup-eve gjatë periudhës së inkubimit dhe deri në përfundimin e zbatimit të projektit të mbështetur financiarisht si startup ose si lehtësues i startup-eve, monitoron periodikisht startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, që kanë fituar masë mbështetëse nëpërmjet granteve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë gjatë zbatimit të këtij ligji.

2. *Startup*-et dhe lehtësuesit kanë detyrimin e raportimit dhe të vënies në dispozicion të dokumenteve të kërkuara nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen brenda një afati konkret.

3. Rregullat e hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për t'u paraqitur nga *startup*-et ose lehtësuesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

4. Shfuqizuar.

KREU III

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5; 8, pika 4; 9 shkronja "a"; 11, pika 5; 12, pika 3; 13, pikat 1 dhe 3, dhe 14, pikat 3 dhe 7, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për sipërmarrjen që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 15, pika 3, të këtij ligji.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.3.2022

**Shpallur me dekretin nr. 13529, datë 29.3.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**